

ZIJA ÇELA
PRINCI I BUZËQESHJES
TREGIME

BOTIMET TOENA

Zija Çela

Princi i buzëqeshjes

*33 tregime për adoleshentë,
por edhe prindër e fëmijë*

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2016

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore letrare: Anrila Spahija

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Albana Kuraj Gega

ISBN 978-9928-205-35-3

© Autori & Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi i materialeve që përmban ky libër me asnjë mjet apo formë, as me fotokopje, as pjesërisht, pa lejen me shkrim të Botimeve Toena.

Botimet TOENA

Rr. "M. Gjolllesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Një Princ që na buzëqesh

Parathënie

1

Në letërsinë botërore duket se librat me titujt që përmbajnë fjalën *Princ*, kanë qenë vërtet me fat të veçantë, po aq sa ç'është dhe titulli Princ një privilegj mbretëror në përditshmërinë e zakonshme. Madje, përveç statusit të kurorës, Princi është edhe një shëmbëlltyrë përrallore, shëmbëllesë e atyre rrëfenjave dhe kallëzimeve që i kemi dëgjuar qysh në vitet e hershme të jetës sonë. Pra, një narracion letrar: Princi që vihet në kërkimin e Hirushes; Princi që dashuron një vajzë të varfër; Princi që guxon të luftojë kuçedrën e që në fund çliron pengun e saj; Princi si personifikim për çfarë dëshirojmë, simbol i ëndrrës më sublime.

Lexuesi nuk e ka të vështirë të kujtohet posaçërisht për tre libra të letërsisë botërore, të cilët na vijnë ndër mend si librat më fatlumë: “Princi i lumtur” i Oskar Uajlldit, “Princi i vogël” i Ekzyperisë, “Princi dhe i Varfri” i Mark Tuenit. Janë libra që kanë bashkuar statusin mbretëror të rangut Princ me statusin mbretëror të mjeshtërisë së lartë të tre autorëve.

Letërsia shqipe guxon të shtojë dhe një princ të katërt, “Princin e buzëqeshjes” të Zija Çelës. Një shkrimtar që ka provuar prej kohësh se romanet dhe tregimet e tij kanë status të lartë, larg letërsisë së rëndomtë stinore. Madje, duke lexuar këtë libër të ri me proza të shkurtra, dëshiroj të kujtoj se edhe përgjatë viteve, sa herë ka shkruar tregime, Çela është shfaqur estetikisht si autor me statusin e tij princëror.

Një *Princ* që na buzëqesh që në titullin e librit, drejtpërdrejt në ballinë. Një princ i mirë, ashtu siç janë ata të rrëfenjave dhe të letërsisë së shkruar. Por do të tregoheshim të mangët, nëse burimin e buzëqeshjes do ta kufizonim thjesht te princi. Në fakt, është vetë Mirësia njerëzore që mund të quhet princ a princeshë. Dhe po të vazhdojmë me zhvokshjen metaforike të matrushkës ruse, tek e cila kur heq një kukull të shfaqet një tjetër, atëherë sapo ke zbuluar mirësinë që e mbulonte princi, ja ku na shfaqet vetë autori që na buzëqesh, sepse paskësh qenë fshehur pikërisht pas mirësisë.

I vëmendshëm që të jetë i saktë deri në fund, autori ka nxituar të na kujtojë me anë të një nëntitulli shpjegues, të vënë në kllapa, se tekstet e këtij libri janë “33 tregime për adoleshentë, por edhe prindër e fëmijë”. Një mundim i kotë. Pasi një shkrimtar që merr përsipër të shkruajë një libër, duke mëtuar se është për fëmijë, gjithmonë do të ballafaqohet me mëdyshjen paradoksale: A jam i rritur aq sa të mund të shkruaj për fëmijë?

Tre librat e famshëm që përmendëm në krye, janë libra që lexohen nga fëmijët, të cilët nesër do të bëhen burra e gra, si dhe nga të rriturit që sot shpresojnë të kenë

mbetur edhe fëmijë. Në këtë rast vetiu të shkon mendja te paradoksi i Ajnshtajnit. Kur u pyet se cili ishte sekreti i gjenisë së vet, shkencëtari i madh u përgjigj: Sekreti? Ndoshta se kam mbetur fëmijë për një kohë shumë më të gjatë nga të tjerët.

Tregimet e këtij libri janë të llojit të letërsisë fatlume, që lexohet në çdo moshë. Në fund të fundit një Princ ka aq forcë tërheqëse, sa t'i magjepsë të gjithë, po ashtu si dhe bukuria e Helenës së Trojës që magjepste njëherësh fëmijët dhe pleqtë e moçëm. Po aq sa dhe ëndrrat e paarritshme. Ose në dukje të paarritshme. Heminguej është shprehur se libri, që ka ndikuar më shumë nga të gjithë librat e tjerë në krijimtarinë e vet, është një libër për fëmijë që titullohet “Tom Sojer”. Një libër të cilit e gjithë letërsia moderne amerikane i ka një borxh të madh, ngulte këmbë Heminguej.

2

Më 2012-n shkrimtari Zija Çela botoi njëherësh dy përmbledhje me tregime, “Pika drite në Eklips” e “Buza e kuqe dhe Gjaku i errët”. (Dyzet vite nga tregimi nismëtar. Dyzet vite që, krahas romanit, lëvron edhe prozën e shkurtër.) Vëllimi i parë përmbledhite tregime të shkruara e të botuara deri në vitin 1990, ndërsa i dyti ato pas 1990-s.

Jam i mendimit se ai botim i Zija Çelës duhej të qe konsideruar, pa asnjë mëdyshje dhe pa asnjë teprim, një festë letrare. Sapo i ke lexuar tregimet e të dyja përmbledhjeve voluminoze, kufiri kohor sfumohet dhe bëhet inekzistent, sepse tregimet kanë një koherencë të jashtëzakonshme artistike.

Po qe se Zija Çela, për një trill kokëshkrepeje, tregimin e parë (kronologjikisht) do ta kishte zhvendosur si tregimin e shkruar në fund, dhe tregimin e fundit ta datonte si të shkruar para dyzet vitesh, asnjë lexues (me gjasë as studiues letërsie) nuk do ta kishte vënë re këtë zhvendosje. Sepse koha te shkrimtarët e mirë është vetëm Art.

E po kështu edhe me këtë libër princëror. Nëse Zija Çela do të këmbëngulte se libri i tij më i fundit ka tregime që i adresohen vetëm një lexuesi të përcaktuar nga vitet e moshës, pas lëçitjes çdokush do të dyshonte për ndonjë kurth shakaje të autorit, i cili ka dashur të vërë në provë shijen dhe pjekurinë e lexuesit.

Sepse koha prapë (këtë radhë te lexuesit) *asgjësohet* përballë mjeshtërisë artistike. Është ai, Princi i Mirë, që u buzëqesh të gjithëve dhe jo një a dy njerëzve.

Të githëve. Dhe në çdo kohë.

3

Me këtë libër Zija Çela duhej të ishte ndodhur përpara vështirësisë së atij shkrimtarit, i cili pasi ka botuar dy vëllimet që kanë shënuar *watershed*-in e prozës së tij të shkurtër, ballafaqohet me mëdyshjen: Po tani?! Është dilema e atij thyerësit të rekordit, i cili ngurron të marrë pjesë në garën e ardhshme, nga droja se mos mbetet prapa rezultatit të mëparshëm.

Zija Çela duket se, çuditërisht, nuk e ka pasur këtë kompleks. Dhe me të drejtë, sepse tekefundit bota krijuese e Artit bën që çdo libër, çdo pikturë a pjesë muzikore të jetë një mini-univers paralel, i ngjashëm

me veprat e tjera ngase ka të njëjtat ligje e materie në përbërjen e vet, po aq sa dhe i pakrahasueshëm, si çdo botë paralele, madje edhe me vetë veprat e të njëjtit autor.

Princi i Mirë na sjell tregime të mrekullueshme, nota të reja që janë tjetërsoj, që kanë ndjeshmëri, butësi, imagjinatë, poezi, stil përrallor, të përcaktuara nga adresimi (i përfytyruar) ndaj një lexuesi adoleshent.

Mirëpo, në të vërtetë, këto tregime përballojnë njëkohësisht lexuesin e ditur, të rrahur me vaj e uthull me letërsinë e mirë, në atë shkallë sa ta shfaqin autorin si një tregimtar po aq të veçantë dhe po aq të fuqishëm, sa Koliqi e Kuteli. Vetë Princi i Mirë bën kujdes që të na sjellë përmes tregimeve gjuhë të zotëruar mjeshtërisht, trille shkrimore, ngjarje tërheqëse dhe situata të veçanta, karaktere ballkanike dhe universale, nganjëherë gogoliane-ballkanike dhe herë të tjera karaktere rrëfimesh të çuditshme të treguara netësh si te Kuteli.

“Princi i buzëqeshjes” sikur do të na kujtojë disa herë Italo Kalvinon, i cili ngulte këmbë se ç’shembull i jashtëzakonshëm është stili përrallor sidomos për tregimin e shkurtër. Andaj Zija Çela na sjell “Engjëjt”, shkruar me delikatesën e përrallave të Oskar Uajlldit, tregim i pakompromentuar nga asnjë klishe, qofshin dhe klishtë subkoshiente që na vijnë pa kuptuar. I paharrueshëm, si tregim kompakt dhe magjik, mbetet “Qengji i grigjës”. E po në këtë libër “Kuçedra”, një alegori e dhimbshme e realitetit tonë, por që tregohet mjeshtërisht si përrallë. Ndoshta ky tregim do të ishte marrë si shembull nga Kalvino se si duhet shkruar tregimi

bashkëkohës përmes mjeteve shprehëse të përrallës. Sepse “Kuçedra” është njëkohësisht edhe tërheqës e zbavitës, elemente aq të domosdoshme të letërsisë së mirë. E këto përgjithësisht i mungojnë letërsisë sonë, e cila vuan nga varfëria e toneve dhe serioziteti i tepëruar didaktik. Princat e mirë janë të buzëqeshur, shërbyesit dhe zemërvegjëlit janë gjithmonë të zymtë.

Princi i Zija Çelës ka ditur të na vijë si Princ i vërtetë: me klasin estetik, me hijeshinë stilistikore, me larminë dhe ngjyrat e titujve, me premtimin se ka ardhur i vendosur ta trashëgojë legjitimitetin e kurorës së Princave të mëdhenj paraardhës të mbretërisë së letërsisë.

Rudol MARKU

Engjëjt

Alarmi u dha njëherësh edhe në Mamac, edhe në Barabi. Të gatshëm si çdo ditë, gjahtarët rrëmbyen çiftet dhe vrapuan drejt fushës për të qëlluar, por atje ndaluan të stepur. Armët u ngrinë në dorë: sipër nuk po shihnin as laraska, as mëllenja, as pëllumba të butë. Përmbi kokat e tyre fluturonin engjëj. Po, engjëj të njëmendtë, të njomë e të bukur, me flatrat e brishta që u ndrisnin në diellin mëngjesor. Veçse në harenë e pastër, për çudinë e gjahtarëve, ata nxirrnin ca kuitje që të kujtonin të qeshurën e njeriut.

Por nga vinin? Dhe si ishin shfaqur aq papritur në qiellin e zbrazët të Fushës së Kungujve?

Pikërisht në këtë fushë, prej kohësh shumë të moçme, thuhej se Zoti kishte ujdísur njerëzit e parë, që do të popullonin njëmbëdhjetë vendbanimet rreth e rrotull. Providenca e kishte marrë vendimin: secili do të mbetej kurdoherë më pak se një qytet, por gjithnjë më tepër se një fshat, ndërsa vetëm katër prej tyre do të njiheshin në të gjithë krahinën si Katër Fuqitë e Mëdha.

Ç'është e vërteta, pasi të kalonin qindra vjet, asnjë nga pasardhësit nuk do të dyshonte se të gjithë stërgjyshërit e tyre ishin krijuar në të njëjtën fushë dhe të njëjtën ditë.

Madje, për nga radha, ata pranonin se të parët kishin qenë banorët e Malashtit. Por renditja ngjallte sherr të madh për fundin. Mbas Skuterrës, që shqiptohej edhe Skëterrë, mbas Likenit e Dardhaliut, banorëve të Pashkasheshit, të Bardhgolemit, të Gjinucit dhe të tjerë, cilët kishin qenë vrima e fundit e kavallit? Troç, kruajtja e kazanit?

Sipas gojëdhënës për zanafillën, që në ato vise besohet edhe sot e gjithë ditën, Zoti i kishte shtrirë krijesat e veta në fushë varg e varg, krejt cullakë dhe me kapakun e kokës të hapur. Një kazan i lartë, plot me tru, mbartej andej-këtej midis rreshtave. Të caktuarit me punë mbushnin nga një garuzhdë me brumin peltor dhe, mbasi ia vendosnin secilit në kokë, ia mbyllnin kafkën si të ishte ndonjë kuti. Megjithëse puna kishte nisur në të zbardhur, tërë paraditen vazhdoi pa ndërprerje.

Aty nga dreka, i çuan fjalë Zotit se tashmë ishin krijuar nëntë palë njerëzish për nëntë vendbanime, por ende jo për ata që do të jetonin në dy vendbanimet më të afërta, ballë për ballë me njëri-tjetrin. Erdhi përgjigjja që trutë e mbetura në kazan të përziheshin me kunguj. Edhe pse u habitën disi, të caktuarit me punë e zbatuan porosinë.

Por pa kaluar ora, u vunë përsëri në zor: ata njoftuan se kazani po zbrazej, sepse edhe trutë e përziera me kunguj po mbaroheshin. Atëherë Zoti urdhëroi që të tjerëve t'ua mbushnin kokën vetëm me kunguj. E bash në këtë pikë haste sharra në gozhdë: Cilët ishin trukungujt, banorët e Barabisë apo të Mamacit?

Që nga ajo kohë, tërë rrafshinës me shkurre e zaje i mbeti emri *Fusha e Kungujve*. Dy vendbanimet përkundraill kurrë s'i pushuan meritë dhe akuzat e ndërsjellta, derisa një ditë mamacianët ndërprejnë çdo lidhje me ata të Barabisë apo të Barbarisë, siç ua shtrembëronin emrin me kast. Se ç'bëhej përtej, në anën tjetër të fushës, në Mamac as që donin t'ia dinin. Ndryshe nga barabiasit, që i njihnin mirë llojet e kungujve, i mbillnin në kopshte dhe i hanin me neps, mamacianët as që e vinin kungullin në gojë, duke dashur të dëshmonin kështu pastërtinë e origjinës së tyre. Dhe me këtë rast shfrenin: "Përderisa kundërshtarët tanë e përlajnë kungullin si buajt, madje edhe farat i pjekin në tepsi, do të thotë se trukungujt janë ata!"

Megjithatë, ky argument nuk mjaftonte për t'i qetësuar përfundimisht. Prandaj, kur një mamaciani i afrohej vdekja dhe të tjerët i luteshin që të shprehte dëshirën e fundit, ai shpesh kërkonte ta kthenin me fytyrë nga Barabia. Dhe duke vështruar andej, ankohej plot brengë:

"Ah, si po largohem nga kjo botë, pa e marrë vesh mirë se kush janë trukungujt! Prej pengut të thellë, as dheu s'ka për të më tretur."

S'do mend, pengu i të vdekurve e rriste më tepër padurimin dhe zemëratën e të gjallëve. Erdhi një ditë që, mbasi tokën e kishin ndarë me kufij (asnjë barabiasi nuk i lejohej të shkelte në Mamac, kurse çdo mamacian shpallej tradhtar po të shkonte në Barabi), vendosën që ta ndanin në mes edhe qiellin.

Dhe siç thanë, ashtu bënë. Por u doli punë me shpendët. E ku dinin krahët e pupacit se ç' ishte inati i Mamacit?! Nga ta merrte vesh kumria se ku e kishte sinorin Barabia?! Sidoqoftë, betejat me shpendët i nisën të parët mamacianët. Gjahtarët vigjëlonin nëpër fushë dhe çdo fluturak që vinte nga ana tjetër, e prisnin me çiftin ngrehur. Bllokadës së tyre ajrore iu përgjigjën edhe barabiasit. Në këtë gjah, ku vriteshin grifsha, laraska, harabela, gushkuqë e kryeartëza, s'u përjashtuan as dallëndyshet. Sa më shumë rritej kërdua kundër shpendëve, aq më tepër po shfaqeshin shenjat e një sëmundjeje të habitshme te njerëzit. Ishte një epidemi e padëgjuar më parë, një lëngatë që zinte vetëm foshnjat dhe shoqërohej me zjarrmi, por sidomos me dhimbje e përskuqje në pjesën e brinjëve. Mjekët e Mamacit u dërguan telegrame mjekëve të Barabisë. Morën përgjigje se, edhe matanë, vocërrakët kishin të njëjtat shenja lëngate. Por megjithëse lajmi ishte ogurzi, burrat nuk i ulën armët.

Pak nga pak, qielli përmbi fushë po shkretohej. Nuk mbetën më puplorë, përveçse pëllumbave të butë. Kur nisën ta kalonin kufirin edhe ata, gjahtarët ishin bërë aq të pashpirtë, sa nuk ua kursenin saçmat, por i kositnin në ajër. Të kapur në befasi, thua se i mahniste pabesia e njeriut, pëllumbat mblidhnin krahët në çast dhe, krejt të përgjakur, plandoseshin drejt tokës si shtëllunga flake. Ndërkaq edhe ethet përparonin dhe zjarrmia, që vinte duke u rritur me ngulm, e ndezi përskuqjen e foshnjave.

Alarmi u dha njëherësh edhe në Mamac, edhe në Barabi. Të gatshëm si çdo ditë, gjahtarët rrëmbyen çiftet dhe vrapuan drejt fushës për të qëlluar, por atje ndaluan të stepur. Armët u ngrinë në dorë: sipër nuk po shihnin as laraska, as kumri. Nuk ishin as pëllumba të butë, sepse gjithë shpezëria, e llahtaritur nga mungesa e mëshirës, kishte marrë përgjithmonë arratinë. Përmbi kokat e tyre fluturonin engjëj. Po, engjëj të njëmendte, të njomë e të bukur, me flatrat e brishta që u ndrisnin në diellin mëngjesor.

Veçse në harenë e pastër, për çudinë e gjahtarëve, ata vazhdonin të nxirrnin ca zëtha gazmorë, që ta çatrafilonin zemrën. Të shtangur e të nemitur, në fillim gjahtarët pandehën se vinin nga qielli. Por pandehma doli e gabuar, pasi nuk zbrisnin nga lartësitë. Përkundrazi, i përkisnin mbretërisë së tokës dhe vinin pikërisht nga Mamaci e Barabia. Pas atyre shenjave të çuditshme, me ethe, zjarrmi e dhimbje në pjesën e brinjëve, foshnjave u kishin dalë flatra. Vocërrakët ishin bërë engjëj dhe tani fluturonin së bashku, duke e kapërcyer lirisht, këtej dhe andej, kufirin e Fushës së Kungujve. Ndoshta jo më kot gazmimi i tyre të kujtonte të qeshurën e pafajshme, atë të qeshurën që është aq e çiltër dhe tejçuese, sa i jep tingull edhe ajrit.

Tiranë, tetor 1997

Shi me diell

(Pioggia con il sole)

Një vit më vonë, kur Livia erdhi përsëri në Tiranë, në katin ku banonte gjyshja e saj gjeti fqinjë të tjerë. Kështu u njoh me Jolën, e cila sapo i kishte mbushur të njëmbëdhjetat, ndërsa Livia bëhej nëntë vjeçe në nëntor. Ishin pushimet verore të shkollës dhe vajzat shoqëroheshin shpesh.

Një mbasdite, teksa luanin në sheshin e pallatit, Jola pikasi një njeri të dashur dhe i buftoi zëri gëzueshëm: “Babi, babi!” Pastaj menjëherë deshi të lëshohej drejt tij. Por ishin të kapura për dore me Livian dhe, kur provoi ta tërhiqte me vete edhe atë, ndjeu se tjetra kishte shtangur. Madje kaq u nguros, sa në vend të bënte përpara, Livia hodhi një hap prapa. Tashmë gjithë trupi i saj, me forma si trupi i balerinës, sikur ishte tkurrur papritur. Megjithatë, për të mos e penguar shoqen në hovjen e saj, ia lëshoi dorën që mbante shtrënguar.

Ndërkohë që zbriti me ashensor edhe mamaja e Jolës, i ati e kishte ndezur makinën. Ata i përshëndetën vajzat me dorë dhe u larguan, pa kuptuar se çfarë kishte ndodhur. Po shkonin në Qendrën Kulturore për provat

e teatrit. Atëherë, si mbetën vetëm, Jola e pyeti miken e vogël përse ishte ndrojtur ashtu. Dhe, gjithnjë e habitur, shtoi:

“A nuk vrapon ti me krahët e hapur, kur e sheh babin ose mamin përballë teje?”

“Unë nuk e kam babin”, tha Livia. “Dhe kurrë s’kam vrapuar drejt tij, sepse kur ka vdekur ai, unë kam qenë tremuajshe. Babin e njoh vetëm në album. Gjyshja më ka thënë njëherë se babushi im, që më parë ishte njeri, tani është bërë fotografi.”

Befas sytë e tjetrës ndryshuan dhe u duk sikur, prej ca avujsh të nxehtë, çuditërisht syzet e saj po kriseshin. Jola e kishte të pamundur ta fshihte dhembjen. Teksa kapsalliste qepallat, lotët që tashmë i rrëshqisnin vetiu, ia stërpiknin edhe xhamat. Mirëpo kur nisi ta përqafonte Livian, u krijua një gjendje tjetër, sepse vajzat po buzëqeshnin njëkohësisht. Moti ishte i mirë, qielli pa një re, kurse gjendja e tyre si ai shiu i brishtë që dielli e përndrit.

Me të vajtur në shtëpi, Livia iu afrua santuarit ku, bashkë me shandanin e qirinjve dhe buqetën e luleve, gjyshja mbante foton e djalit të ndjerë, babait të Livias. Aty sikur ngriu, sepse nuk po kuptonte çfarë kishte ndodhur. Përgjatë xhamit kishte ca vilarë të lagësht, si të ishin gjurmë lotësh. Ajo e dinte se, kur ndodhej vetëm në atë dhomë, herë-herë gjyshja e merrte foton në dorë dhe afrohej te dritarja për ta parë më mirë. Pastaj, duke vështruar nga rruga, thua se shpresonte që djali mund t’i kthehej andej, përlojej e gëlltitej pa nxjerrë zë. Mos kishte qarë, ndërsa Livia shoqërohej me Jolën? E pyeti

gjyshen. Por ajo nuk foli, vetëm hapi perden që drita të hynte më bollshëm. Vallë, a ishte e mundur që lotët e Jolës të kishin arritur edhe këtu? Në atë foto babushi i Livias kishte dalë buzagaz dhe, sapo u hap perdja, ngaqë vërshoi drita apo prej buzëqeshjes së tij, xhami i kornizës rrëzëlleu gjithë shkëlqim.

Në shtëpinë e saj në Castelnovo, përtej detit në Itali, edhe Livia mbante një foto në komodinën pranë krevatit. E vogël fotografia, por korniza që e rrethonte, si për ta mbajtur sa më butë, ishte krejt prej lëkure. Një mëngjes, kur Livia ishte pesë vjeçe, e rrëzoi pa dashje nga komodina. Vogëlushja u gjunjëzua menjëherë, e ngriti foton me kujdes dhe, duke pandehur mos ia kishte troshitur kockat, iu drejtua të atit gjithë dhembshuri: “U vrave? Më fal, babi, më fal! *Scusa, scusami*, të lutem!”

Këtë ngjarje vetëm tani ia kishte rrëfyer gjyshes. Sigurisht, Livia nuk ishte më aq naive sa më parë dhe priti që, sado pak, gjyshes t’i ndryshonte humori. Por fytyra e saj mbeti e ngrysur, sikur nga brenda të kishte vetëm errësirë. Megjithatë e mbështeti te gjoksi i vet kokën e mbesës së shtrenjtë dhe, duke ia përkëdhelur flokët ngadalë, i tha: “Sa mirë që kërkon falje, Livia ime! Shpirti i njeriut njëlloj rrezikon të prishet në tri raste: kur harron të qeshë, kur harron të qajë dhe kur harron të kërkojë ndjesë.”

* * *

Ja ku janë përsëri bashkë dy mikeshat. Dhe janë në shtëpinë e Jolës. Por deri tani ajo s’u ka folur prindërve

për atë ngjarjen me Livian. Tashmë ato janë mike besnike dhe kanë intimitetet e tyre.

Është prapë pasdite, koha kur mamaja e Jolës do ta shoqërojë të shoqin në Qendrën Kulturore. Pas disa ditësh atje do të hapet Festivali i Teatrit Amator. Babai i Jolës punonte në një bankë të madhe. Për këtë zotëri thuhej se ishte njeri i drejtë. Por duke qenë karakter i fortë, nganjëherë sillej ashpër me vartësit dhe merrte vendime të rrepta. Bankat e kryeqytetit do të paraqiteshin me një trupë të përbashkët teatrore dhe me një dramë, që e merrte subjektin nga antikiteti. Ndoshta pikërisht për natyrën e tij, babain e Jolës e kishin zgjedhur që të luante rolin e Agamemnonit, kryekomandantit të ushtrisë helene në Luftën e Trojës. Para se të nisnin betejat, për të siguruar me çdo kusht përkrahjen e perëndive (atëherë njerëzit besonin në shumë Zota), ai do t'u blatonte atyre një flijim shumë të rëndë, madje mizor. Pikërisht për këtë po flisnin bashkëshortët. Burri thoshte se në çastin e flijimit, sado zemërfortë dhe i vendosur të sakrifikonte gjithçka për fitoren, prapëseprapë si baba duhej t'i shpëtonte ndonjë lot në skenë. Mirëpo ai nuk ishte aktor i vërtetë, kështu që e kishte të vështirë të hiqej sikur qante.

Biseda bëhej në dhomën tjetër. Veçse, meqë dyert ishin të hapura, zërat e tyre arrinin deri te vajzat. Mamaja e Jolës filloi ta këshillonte të shoqin: “Po sikur atë çast t’ia kthesh shpinën sallës dhe t’i ngacmosh sytë me gisht?”

“Oh, jo!”, s’u pajtua ai. “Këtë gjest ia propozova edhe unë regjisorit. Por ai më tha se, po ta kuptonin shikuesit,

do të talleshin me mua dhe mund të më gjuanin me qeska patatinash. Kur humb besimin e spektatorit, tërë shfaqja kthehet në dështim.”

Gruaja vrau mendjen, pastaj e këshilloi ndryshe: “Atë çast kujto legjendën e Rozafës. Ti e di si u ngrit kalaja e Shkodrës. Në muret e saj u flijua një nuse, kur shkoi për t’ua çuar drekën tre vëllezërve që punonin aty. Ishte gruaja e vëllait të tretë. Ai e mbajti fjalën dhe nuk e paralajmëroi Rozafën për t’i bërë bisht atij rengu, siç i paralajmëruan dy të tjerët gratë e tyre. Në skenë ti mendo sikur je vëllai i tretë dhe do të më murosësh mua.”

“Oh, jo, jo”, kundërshtoi prerë ai. “Diçka që s’do ta bëja kurrë, nuk mundem as ta përfytyroj.”

Dihet se, në të vërtetë, Agamemnoni kishte flijuar në Aulidë bijën e tij, Ifigjeninë e dëlirë. Por pas asaj përgjigjeje, gruaja nuk e ngau më tej bisedën. Ajo s’mund t’i thoshte që, në çastin më të vështirë, ta interpretonte rolin duke përfytyruar Jolën, vajzën e tyre të zemrës.

* * *

Kur filloi festivali, në dy shfaqjet e para Jola e mori me vete edhe Livian, miken e pandashme. Patjetër në shfaqjen e katërt, ku luante babai i saj. Natyrisht, gjithnjë nën shoqërimin e zonjës. Pa i thënë njëra-tjerës gjysmë fjale, të trija po prisnin me ankth atë çastin më delikat, kur i prekur thellë nga akti që do të kryhej në emër të fitores dhe të lavdisë, kryekomandanti zemërfortë do të përlotej. Ndonëse

edhe për vetë spektatorët ndoshta u duk e papritur, pasi babai i Jolës nuk kishte bërë as ndonjë kurs të përshpejtuar për aktor, ia doli mbanë. Teksa mbante vështirimin jashtë skenës, andej ku po kryhej flijimi, ai uli kokën, pastaj nxori shaminë e mëndafshhtë dhe nisi të fërkonte sytë. Kur e ngriti kokën, gjithë atij burri po i shkonin lotët çurg nëpër faqe. Spektatorët ia shpërblyen ndjeshmërinë e lartë, salla shpërtheu menjëherë në duartrokitje.

Me t'u kthyer në shtëpinë e gjyshes, si ta tërhiqte një forcë e pakuptueshme, Livia nxitoi te fotoja e babushit. Por xhami ishte i thatë. Madje, megjithëse perden e dritares e hapi tej e tej, nuk dalloi ndonjë gjurmë.

Të nesërmen, kur u takua me Jolën dhe ra fjala për shfaqjen, Livia e lavdëroi babain e mikeshës duke thënë se, përderisa kishte arritur të qante gjatë rolit, ai ishte një aktor i madh. Dhe ca nga entuziazmi, ca nga dëshira e mirë, e lëshoi gojën më tepër:

“Pse jo, ndoshta bëhet edhe artist kinemaje, një star!”

“Po jo, moj Livia”, tha Jola, “ata nuk ishin lot të vërtetë. Mami u mendua sa u mendua dhe, më në fund, e gjeti marifetin. I dha babit një shishe të vogël me lëng për ta lagur shaminë para skenës së flijimit. Dhe e di çfarë lëngu ishte? Lëng qepe!”

Vajzat u panë sy më sy. Veçse kësaj here të dyja ishin të shtangura. Po kur Jolës po i varej koka në gjoks, thua se i rëndonin gjithfarë mendimesh të zymta për marifetin, Livia sikur e mori veten dhe e nxiti tjetrën me afsh:

“Qesh, Jola, qesh! Zemra ime gëzon kur ti qesh.”

Vajzat mbetën shoqe të ngushta përgjithmonë. Madje ndërsa rriteshin, edhe Livia vuri syze. Ato herë i shkruanin njëra-tjetrës në postën elektronike, herë flisnin në skajp.

Livia ishte ende studente, kur i mbërriti një ftesë e gëzueshme. Jola do të martohej. Natyrisht, mikësja s'mund të mungonte në atë dasmë. Nuk mungonin aty as kushërinjtë, as fqinjët më të afërt. Sheshi i pallatit ku shtruan tryezat, u mbush me dasmorë. Prindërit e Jolës ranë në hall: Po ta kishin ftuar gjyshen e Livias në dasmë, ajo sigurisht nuk do të shkonte. Që kur djali i saj kishte ndërruar jetë, s'i kishte hequr nga trupi rrobat e zeza dhe fort rrallë dilte nga shtëpia. Por edhe tani që jashtë binin muzikat, kishin frikë mos po e lëndonin. Nga merak, mamaja e Jolës deshi të ngjitej lart me Livian, për të parë se ç'bënte gjyshja.

Mirëpo në atë çast, si për habi, fytyra e saj u shfaq në dritare. Zërin ia mbysnin veglat muzikore, por nga lëvizja e buzëve kuptohej se diç po thoshte. Mos ishte lënduar aq hidhur, sa po e mallkonte këtë dasmë, që ia prishte heshtjen e gjatë dhe të pikëllueshme?! Mirëpo, ndonëse nuk e dëgjonte askush, gjyshja po thoshte: “Këndoni, këndonin ju këndoftë zemra! Ndoshta atëherë kur unë kam qenë duke kënduar, ndonjëri prej jush ka qenë duke qarë.” Dhe vërtet, sa shumë kishte kënduar ajo ditën që ishte martuar i biri! Edhe valle kishte hedhur me krushqit.

Të dielën në mëngjes dasmorët iu drejtuan kishës.

Jolën e veshur nuse e shoqëronin prindërit, ashtu si dhëndrin e shoqëronin prindërit e tij, të cilët flisnin vetëm anglisht. Me të mbaruar ceremonia, bashkë me dhëndrin e nusen, ata do të fluturonin për në Kanada.

Teksa po dilnin nga kisha, prindërit e Jolës kaq u mallëngjyen, sa mamaja e saj nuk i fshehu lotët. Por edhe babai sikur nuk po mbahej. Ai nxori shaminë nga xhepi i kostumit dhe... Kushedi përse, Jola e Livia panë me ngulm njëra-tjetrën, si t'u kishte mbetur ndonjë kujtim nga lotët e qepës. Por ky qe vetëm një çast i shkurtër, sepse edhe vetë mikeshat po mallëngjeheshin. Madje, thua se prej pahut që i mori fytyra, skeleti i syzeve të Livias dukej edhe më i kuqërremtë. Ndërsa xhamat... Po, xhamat thuajse u plasaritën krisa-krisa. Atëherë, duke i gëlltitur lotët me të shpejtë, mikja e saj iu lut:

“Qesh, Livia, qesh! Zemra ime gëzon kur ti qesh.”

“Shpejt, shpejt!”, thirri dikush, duke treguar me dorë makinën e çiftit. “Shpejt, se ju zuri shiu!”

Të tjerët kthyen kokën të habitur. Qielli vërtet kishte pak re, mirëpo dielli rrëzëllente si një kanistër e mbushur me perla. Në këto kushte as që mund të bëhej fjalë për shiun.

Por gjyshja e Livias, e cila kishte ardhur aty për t'i dhënë çiftit bekimin e saj, ashtu e ndiente. Dhe sipas dy mikeshave, nuk po gabohej, sepse ka edhe perla që nuk krijohen ndryshe, veçse nga kokrrat e lotit. Të paktën, kështu besojnë disa.

Castelnovo, maj 2014

Sa larg, sa afër...

Meqë ajo faqe muri ishte skërfitur nga lagështira, çka i jepte korridorit një pamje të vjetruar, thirrëm një punëtor që e suvatoi nga e para. Kur u largua në të errur, babai mbeti i pakënaqur me pastrimin dhe ma ngarkoi ta bëja unë të nesërmen. Në familjen tonë, ç'është e drejta, mua më takonte. Ai kthehej vonë nga Instituti i Studimeve Minerare, ndërsa nëna, pas aksidentit me makinë, kishte mbetur uloke dhe lëvizte nëpër shtëpi me karrocën e invalidit. Por në këtë rast kishte dhe një shkak më tepër. Atë pasdite s'i kisha hequr atletet nga këmba, kështu që nga korridori kisha çuar gjithfarë pluhurash deri në dhomën time.

Të nesërmen pastrimi pothuaj më doli nga mendja. Në gjimnaz nxënësit ngarkohen çdo ditë dhe me t'u kthyer nga shkolla, teksa haja drekë, i hidhja ndonjë sy librit të algjebres. Pastaj, teksa zgjidhja problemat, i hidhja ndonjë sy edhe orës. E kisha lënë me Stelën, shoqen time të klasës, të venim në kinema. Ishte hera e parë të dy bashkë, herët e tjera kishim qenë në grup. Prandaj, për këtë takim kaq të lakmuar, as minuta s'më

falej po të vonohesha. Kështu më thoshte rradakja. S'kisha ç'i bëja, edhe pse rradakja s'është gjithnjë radar i mirë.

Kur salla u errësua dhe nisi projektimi në ekran, flokët biond të Stelës morën në kundërdritë atë breroren që kanë yjet në netët e vjeshtës. Nuk di si dreqin ndodhi, por më zuri njëfarë frike e befasishme. Filmi fliste për jashtëtokësorët dhe, ndonëse e kisha fare pranë, më dukej sikur nga çasti në çast Stela do të degdisëj diku larg. Dhe ishte vetë ajo që, me atë prarimin yjor, po i provokonte alienët. Madje, pas pak, m'u bë se dëgjova edhe pëshpërimën e saj: "Më rrëmbeni, më rrëmbeni, dua të vij me ju atje lart!" Ç'tërheqje ndjellëse ishte, ç'mister e shtynte të na braktiste ne për një botë tjetër, të panjohur e të pakufishme?! S'i vinte gjynah për globthin tonë?!... Kjo thirrje, afërmendsh, s'mund të ishte e vërtetë. Por mua ashtu më gjasmonte.

Kur u kthye babai nga instituti, më gjeti në tryezë me fletoret e detyrave. Atëherë m'u kujtua pastrimi dhe ngrita duart për ndjesë. Ndoshta atij s'i erdhi mirë, se ca thërrime i kërcitën nën këpucë. Por gjithsesi u pajtua, duke ma shtyrë afatin për të nesërmen. Patjetër, thashë, do t'i hyjë mbarë shtëpisë me fshesë e me leckë.

Të nesërmen nuk mund t'ia fshihja Stelës. I fola për breroren e flokëve, joshjen ndaj alienëve dhe atë frikën time të çuditshme se mos ajo degdisëj larg. Por aq larg, sa pastaj s'më mbetej tjetër, veçse ta shihja si një yll mes yjeve.

"Të shkon mendja se çfarë paske ndier?", pyeti ajo.

“E çfarë?”, përfitova për ta sqaruar sa më shpejt vetveten.

“Në atë çast ke përjetuar mungesën time. Dhe tronditja tregon se çfarë jam unë për ty, domethënë, sa miq të ngushtë jemi.”

Ç’të thoshte më tepër, ishte një shpjegim që ta hiqte trurin.

Në atë gjendje turbullimi shkova në shtëpi. Si hëngra drekë me nënën dhe hoqa qafe detyrat me shkrim, dëgjova muzikë në dhomën time. Me ca çuna të klasës e kishim lënë të takoheshim prapa godinës së bibliotekës, ku bënim numra me skejt-bord në parmakët e shkallëve. Por vendosa të mos shkoja, nuk më dilte koha edhe për pastrimin, edhe për mësimet e reja në tri lëndë. Siç isha shtrirë i veshur mbi rrobat e krevatit, dalëngadalë m’u rikthye ai përfytyrimi i djeshëm për yllin midis yjeve. “Po Stela çfarë qielli sheh?”, pyeta veten. “Jam unë diku atje? Dhe kryesorja, e ndien ajo mungesën time?” Bashkë me këto më vinin edhe pyetje të tjera, por i gëlltisja pa i lënë të ngjizeshin mirë.

E kisha tretur vështrimin nëpër dhomë, kur m’u ndalën sytë sipër raftit, ku babai kishte lënë një valixhe si të braktisur. E dija çfarë mbante, disa harta, dytri busulla dhe një Fjalor astronomie. Në vitet më të vështira, kur punonte në minierë dhe hynte në galeri, inxhinierit të nëntokës i qe zgjuar pasioni për qiellin. Habisë sime nëna i përgjigjej: “Errësira e kërkon dritën dhe drita errësirën ngaqë janë binjake.”

Në atë valixhe zgjodha një hartë dhe e vara në mur. Ishte hartë kozmike, plot e përplot galaktika të mëdha

e të vogla, që unë as i njihja dhe as i ndaja dot. Në një sfond blu mbizotëronin pikëlime të verdha e portokalli, ca shtjella të bardhëlleme dhe prapë ngjyrimë të kuqe, të blerta e vjollcë. Dhe ishte vetëm një fragment qiellor, ndoshta pamje me teleskop special, ndoshta fotografim nga anijet hapësinore. Shkallën e zvogëlimit harta as që e shënonte ndopak, pasi me gjasë ishte e pamundur të shprehej. Vazhdimin e kozmosit, me pafundësinë nga të katër anët, mbetej vetëm ta merrje me mend.

E ku do të ishte Stela atje, nëse këtu do të mungonte vërtet? Kjo mëdyshje, përveç kureshtjes, ma nxiti edhe zellin për ndonjë provë.

Mora një letër të ngjyrosur (kuptohet ç'ngjyrë kishte) dhe preva një shenjë me pesë cepa. Pasi shkrova aty emrin e Stelës, po vëzhgoja hartën për ta ngjitur diku. Unë s'mund ta vendosja atje lart, në largësitë e paarritshme, sepse nuk doja që ajo të merrte arratinë. Prandaj më duhej të hamendësoja ndonjë koordinatë fqinjësie me ne. Po sa i saktë do të isha? U mata sa u mata dhe, më në fund, e ngjita shenjën diku poshtë. Pastaj nisa ta kundroja herë nga një krah, herë nga tjetri.

Babai më gjeti duke e kundruar ballë për ballë. Ia dëgjova hapat në korridor, madje edhe atë kërcitjen e pluhurit. Ndryshe nga dje, po kthehej ca më herët. Mendova se ose do t'i hynte pastrimit vetë, ose bashkë me mua. M'u duk e padenjë të shtiresha, të mblidhja hartën tub, të mbyllja valixhen dhe të merrja në dorë ndonjë tekst shkollor. Ai bisedoi me nënën një grimë herë, pastaj erdhi tek unë. E pashë si iu ngritën vetullat prej befasisë dhe si i shkrepri përbrenda xixa e pasionit të vjetër. Mbasi

përfshiu me sy tërë hartën, tregoi me gisht pesëkëndorin, duke lexuar edhe fjalën që kisha shkruar aty.

“Për këtë yllin tënd paske parapëlqyer italishten”, tha. “Veçse shkruhet me dy *ll*, Stella.”

“Sidoqoftë, shqiptohet Stela”, u mbrojta unë.

“Po, mor bir, njësoj si *bella*.” Dhe menjëherë përsëriti: “Stella, star, étoile... Jam kureshtar të di si i thonë yllit në mongolisht. Njerëzimi i sotëm flet shtatë mijë gjuhë.”

“Dhe shtatë mijë herë kuptimi mbetet i njëjtë: Stela”, më buftoi prej qejfit mua.

Megjithatë nuk doja të hallakatesha më tej, por të sigurohesha për çfarë më interesonte më shumë. Pakëz i ndrojtur (Mos qoftë e thënë të jem gabuar rëndë, i uroja vetes.), pyeta astrologun amator:

“Po planeti ynë ku mund të ndodhet në këtë kaos?”

“Kozmosi nuk është kaos, por harmoni e përkryer. Ndërsa Toka... Hm!”, u frenua babai.

Nga pamja m’u duk se edhe ai nuk e kishte të lehtë ta përcaktonte vendndodhjen e Tokës. Madje më paralajmëroi se do të ishte vetëm e përafërt. Kështu, duke u nisur nga lart, ai nisi të bënte ca matje në tri nivele, të cilat i cilësoi *adresa*, derisa u ndal diku poshtë.

“Më sill një kokërr bizele”, tha. “Jo, jo, bizelja është e madhe, më sill një kokërr oriz”, më prapësoi. Dhe sërish më ndali në çast: “Jo, jo, edhe kokrra e orizit është e madhe.”

Si ta kishte pikasur vetë atë që i duhej, u përkul dhe mori një thërrime rëre. Sa për zamkën, e kishte pranë atë që kisha përdorur unë.

“E pra”, foli duke e ngjitur thërrimen në hartë, “ky është planeti ynë, oazi ku shkelim përditë.” Pastaj, duke tërhequr nga pantofla shputën e djathtë dhe duke e ngritur këmbën, si të ishte i gatshëm për ta hedhur hapin, m’u drejtua: “Ta shtrij hartën në dysHEME? Të shkel unë, apo do të shkelësh ti i pari?”

Aty ku e përcaktoi babai, Toka ishte aq pranë me Stelën, sa dukej sikur mjaft të shtrija dorën dhe e arrija. Por fjalët e tij të fundit sikur më futën drithmat. Vërtet më kishte ndihur fati për afërsinë, por në atë pozicion ishte e pamundur të shkelje njëren, pa shkelur edhe tjetrën.

“Asnjë hap ti, asnjë hap unë”, u mundova të buzëqeshja, sepse edhe ai po buzëqeshte.

Mirëpo fytyra i ndërroi shpejt, kur foli përsëri:

“E mirë pra, rruzulli nuk është si dikur, toka njësh dhe uji njësh. Prandaj ndaje tani në dy hemisfera dhe shpërndaji kontinentet. Por ki parasysh se në hemisferën veriore ato zënë 39 përqind të saj, në jugoren vetëm 18. Dhe mos harro të shtrish ndërmjet oqeanet. Kjo sipërfaqe ujore është 2.3 herë më e madhe se ajo e kontinenteve. Pastaj...”

Ç’po thoshte babai?! Si mund ta shndërroja atë kokrrizë rëre në një planet, ta ndaja në shtatë pjesë, të krijoja shtretërit e thellë e t’i mbushja honet me ujë të kripur?! Por ai prapë s’u përmbajt. Pasi më lypi detet, më kërkoi vargmalin e Himalajave, atë të Kaukazeve, pastaj Alpet, Pirenejtë dhe Andet. Kur pa se isha topitur krejt, i ra fare shkurt:

“Atëherë, të paktën, vendos aty qytetin ku jetojmë. Ia gjete vendin shtëpisë sonë? Kujdes, mos nxito!..

Ç'mbetet tani? Tani mbetet që në shtëpi të vendosësh ndonjë njeri të dashur.”

“Stelën, baba?”, më shpëtoi goja mua.

“Mos pyet më kot, është në dëshirën tënde. Jepi shpejt, po pres që ta vendosësh.”

“Por kë, kë të vendos?”, u sikletosa më keq.

“Nënë tënde, qyqar!”, i shpërtheu zëri atij. “Përse e humb mendjen?! Ylli yt qëndron vetë në qiell, si çdo yll midis yjeve.”

Unë s’e përmenda nënën, sepse e kisha përfytyruar në shtëpi, duke më pritur që të kthehesha nga shkolla. Sidoqoftë, nuk më kishte hije të dorëzohesha në çastin vendimtar. Kështu që u bëra më i drejtpërdrejtë:

“Baba, Stela është mikja ime më e afërt. Prandaj desha ta di distancën që ka ylli i saj nga planeti ynë.”

“Je i sigurt se është ylli më i afërt?”

“Jam”, thashë.

“Atëherë mos harro”, ma ktheu ai, “ylli më i afërt me Tokën është dyzet trilionë kilometra. Si mund të shoqëroheshi bashkë në kaq distancë?!”

Kyçe, i fola vetes pa zë, mos e trash më tej zullumin.

Të nesërmen, kur po ia rrëfeja ngjarjen, pamundësinë e shoqërimit e dëshmoi edhe Stela. Me një furi të papritur, ajo ofshani gjithë magjepsje dhe habi:

“Oh, sa larg më paske degdisur! Po ti pse nuk përdore kozmosin tjetër?! Vërtet, as atij nuk ia njohim krejt misteret, por gjithsesi e administrojmë vetë. Unë prandaj s’e ndiej mungesën tënde, se të kam vendosur aty.”

Nga lëvizja e dorës para kraharorit, diç më erdhi në mendje edhe mua. Por po ngurroja ta pyesja menjëherë nëse kozmosi tjetër është zemra e njeriut.

Tiranë, janar 2015

Kuçedra

Të gjithë e ndjenë se uji po pakësohej, por sidomos gratë. Në fillim ujit i humbi vrulli, pastaj u hollua aq shumë në lëfytet e çezmave, sa gratë iu ankuan njëra-tjetrës: “Këtë curril mund ta përshkosh edhe në vrimën e gjilpërës, si fije peri.”

Shqetësimi i tyre i vuri në alarm burrat.

U mor vesh se ujin e ndalonte kuçedra, një kuçedër e vjetër për të cilën kishte gojëdhëna të ndryshme. Disave iu duk një përrallë, por lajmin e vërtetuan barinjtë, që zbritën nga bjeshka të llahtarisur. Ata pohuan se kuçedra ndodhej në Shpellën e Zezë, bash ku uji kishte amën e burimit. Natyrisht, me sy nuk kishin arritur ta shihnin, por ulërimat e bubutimat e saj i kishin dëgjuar qartë. Për ta lëshuar ujin, kuçedra vinte kushte të rënda, aq të rënda, sa përmbushja e tyre i poshtëronte njerëzit.

Nuk paskësh aty një burrë që të ndeshej ballazi me kuçedrën, të mbronte jetën, lirinë dhe nderin e Malashtit? Kjo thirrje që kalonte gojë më gojë, u shumëfishua përmes gazetës, televizionit dhe radios lokale.

Të gjithë, jo pa shkak, i kthyen sytë nga Gjoni. Gjon Vrano Bala ishte nga ata që, siç thotë një fjalë, u ndez pushka në ujë e të marrin gjak në vetull. Në çdo festë zyrtare vendi i tij ishte në tribunë, përkrah njerëzve më të nderuar. Por midis tyre askush nuk mbante në gjoks aq medalje të mirënjohjes, sa Gjoni i Balajve. Dhe ai e meritonte, sepse disa herë i kishte sjellë shërbime të çmueshme Malashtit. Herën e fundit, vetëm për pak vota nuk u zgjodh kryetar i bashkisë. Qytetarët anuan nga kandidati tjetër, një mësues i shkollës së mesme që, edhe pse nuk ishte dalluar për ndonjë trimëri, mbahej në gojë si njeri i matur e qokatar. Ndoshta Gjoni humbi për gjaknxehësinë e tij, ai kurrë nuk ia përtonte sherrit dhe ata që s'i pëlqenin, sidomos kundërshtarët e vet, i shihte me përbuzje nga lart poshtë, si të ishin miza. "Hë, ç'u gënjen mendja", u thoshte, "pandehni se kjo është koha e dhelprave dhe me dredhira mund të fitoni kahmos?! Koha gjithmonë është e luanëve dhe unë një luan jam!" Të lënduar në sedër, disa pëshpërisnin prapa shpinës së tij: "Ama, cytanik e belaçor i madh mbeti gjithë jetën ky Gjoni, sot i ngul hunjtë dhe nesër i shkul!"

Por me t'u shfaqur kuçedra, u duk se të gjithë u penduan për gabimin që kishin bërë, veçse tashmë ishte vonë.

Megjithatë, Gjon Vrano Bala nuk u mbajti mëri bashkëqytetarëve. Qafëcungal e me supe të rënda, u vesh dhe u mbath fort hijshëm, u armatos deri në dhëmbë dhe, me dellin e një azgani, u nis për t'u ndeshur me kuçedrën. Përbetimi i tij ishte i prerë: Ose e shtrinte përtokë, ose vdiste vetë!

Kur erdhi uji, të gjithë e morën me mend se trimi i trimave kishte dalë fitimtar. Sa për Gjonin, i cili nuk u kthye nga Shpella e Zezë, arsyeja ishte e kuptueshme. Përtej malit shtrihej deti, në bregdet kishte qytete të tjera, ato ishin më të mëdha e më joshëse. Sipas gjasave, prej ajamit që të bridhte anë e skaj, Gjon Vrano Bala po kërkonte tutje aventura të reja.

Shkoi viti i parë, kaloi edhe i dyti. Askush në Malasht nuk ankohej më për ujin. Po kur hyri vera e tretë, në kohë të djegagurit, gratë nisën të shqetësoheshin përsëri. Pastaj uji shteroi krejt, lëfytet u thanë, barinjtë e bjeshkës u kthyen të alarmuar dhe sollën lajmin se tani i kërcënonte një kuçedër e re. Ashtu si më parë, me sy nuk kishin arritur ta shihnin, por ia kishin dëgjuar piskamat e tmerrshme, si dhe kushtet që vinte për ta lëshuar ujin. Kësaj here, përveçse poshtëruese, kushtet ishin edhe të habitshme. Kuçedra kërkonte:

1. Ta pranonin si prijës të tyre, pa votuar në zgjedhje dhe pa asnjë debat publik.

2. Për gjithë sa kishte bërë, në sheshin kryesor të qytetit t'i ngrihej Përmendorja e Lavdisë.

3. Përveç fiksës, si përmendore lëvizëse t'i kushtohej edhe një këngë me 124 vargje, e cila të këndohej në ekran tri herë në ditë dhe tri herë në javë të botohej në gazetë.

Përpara kërkesave të tilla, Malashti u shtang dhe u duk sikur u zu peng nga kuçedra. Pastaj u mbajtën disa mitingje, ku qytetarët jepnin mendime të ndryshme. Një palë thoshin se do t'u dilte më mirë, nëse kuçedrës

ia plotësonin kushtet. Të tjerë arsyetonin: “E përse të dorëzohemi?! Si është e mundur të zmbrapsemi përpara së Keqes, bile t’i këndojmë këngë dhe t’ia veshim shëmbëlltyrën me bronz a mermer?! Kështu do të turpëroheshim për jetë të jetëve.”

Shumë nga pleqtë, që mosha i kishte rrëgjuar dhe kishin mbetur me shkop në dorë, psherëtinin me mall e keqardhje për Gjonin e famshëm: “Ah, tashti ta kishim prapë Gjon Vrano Balën, luanin që s’ia shkel kush hijen! Vallë, ku e ka hedhur vala? Po ta dinim ku ndodhet, ia çonim fjalën në vesh, ai do të kthehej si era dhe na nxirrte nga belaja.” Por, pastaj, i vinin gishtin kokës dhe pyesnin të trishtuar: “Kaq poshtë paska rënë Malashti ynë, nuk gjenden në këtë truall guximtarë të tjerë, burra që e kanë zemrën me kockë dhe mund të ndeshen me kuçedrën?!”

Dhe trimat nuk munguan, dolën vetë vullnetarë.

Përgatitjet u bënë me kujdes. Veç armëve të zjarrit, u siguruan edhe pajime ndihmëse: këpucë alpine, rrotulla litari, gozhdë me hallka dhe rripa sigurimi. Kurse për çdo rast, për t’iu përshtatur mënyrave të luftimit, atyre ndeshjeve të dikurshme që bënin bajlozët dhe që përmendeshin në legjenda, u morën nga muzeu edhe parzmore me sumbulla prej tunxhi, shpata, përkrenare, shtiza, topuzë e mazdrakë çeliku.

Nisja u bë nga sheshi kryesor. Vullnetarët u rreshtuan përpara tribunës, ku buçiste banda muzikore. Trumbetat e buritë nuk reshtën edhe pas nisjes, deri mbasdite vonë. Ndërsa binte nata, ankthi dhe pritja e mbërthyen Malashtin shtëpi më shtëpi. Gjumi për të gjithë kishte

marrë arratinë dhe një peng i mundonte: Ç'po ndodhte në mal, atje te Shpella e Zezë?

Nuk u desh shumë kohë që të arrinte lajmi prej atje. U dëshmuua me prova se, herën e parë, Gjon Vrano Bala e kishte vrarë vërtet kuçedrën. Por më pas kishte veshur gëzofin e saj dhe, kushedi përse, dalëngadalë ishte bërë vetë kuçedër.

Tiranë, mars 1997

Për gjyshin dhe horizontin

Kur ndërroi jetë gjyshi im, ndonëse kishte pasur vetëm një djalë, la gjashte nipa. Mes tyre katër ishin të moshës sime, afër dymbëdhjetë vjeç. Por pavarësisht nga mosha, kortezhi na mori me vete të gjithëve. Të zënë dorë për dore, na vunë rreth varrit të hapur, ku ai do të prehej përgjithmonë. Kurse njeriu që mbajti fjalën e Lamtumirës, pasi u gëlltit disa herë me vështrimin nga ne, kushedi përse tha gjithashtu: “Ja, këta fëmijë janë kurora e tij! Dhe s’ka nevojë për lule të tjera.”

Me sa pashë, të pranishmit miratuan duke tundur kokën. Kalamani më i vogël madje u ngashërye. Por përveç meje, asnjëri nuk ishte nipi i tij i vërtetë. Gjyshi i kishte *birësuar* pak kohë mbasi babai im humbi jetën nga një sëmundje e pashërueshme. Atëherë jetonim në rrethina të qytetit, në një lagje që u popullua shpejt me familje, të cilat kishin ardhur nga fshatrat e thella dhe mezi arrinin të bënin një strehë dosido. Kur i solli në shtëpi për herë të parë, ishte gjithë qejf dhe foli me mua buzagaz. Ai tha se tani e tutje unë do të kisha edhe pesë sivëllezër, të cilët çdo ditë do të hanin drekë në shtëpinë

tonë. Mbasdite, me të mbaruar detyrat e shkollës, mund të luanim lirisht në oborr, ndërsa në muzg do të vinin t'i merrnin familjarët e tyre. Ndoshta këtë *birësim* e bëri për dy shtysa njëherësh, as unë të mos e ndieja vetminë, as ata varfërinë. Megjithëse vetë, në krahasim me xhepin, gjyshi im i shkretë zemrën kishte më të pasur. Por në qytet ishte bërë i njohur, sepse prej shumë e shumë vitesh mbante një dyqan, ku tregtonte mallra ushqimore dhe shumëkush e respektonte për ndershmërinë e tij.

Çfarë kujtoj nga gjyshi tashmë? Të parën do të përmendja një dhuratë të paharrueshme. Ajo ka edhe radhën, sepse dhurata m'u bë kur im atë ishte ende gjallë. Por e lashë rrëfimin aty, ku gjithë sivëllezërit mund të luanim lirisht në oborr. Një ditë, prej reve të ngarkuara me shi, kaq e ulët dukej kubeja e qiellit, sa të thoshte mendja se mbyllej menjëherë në fund të lagjes sonë. Ne këtë po i thoshim njëri-tjetrit, madje me njëfarë bindjeje sikur, po të kishim dëshirë, do të arrinim atje me një vrap pele.

“E pra, ju mund ta prekni me dorë atë vijën përmbyllëse?”, na foli gjyshi, i cili i kishte dëgjuar hamendjet tona. Pastaj, si në një garë të vërtetë sportive, na ftoi të rreshtoheshim krah më krah dhe vazhdoi: “Të shohim se kush do të dalë i pari. Nisuni tani!”

Dhe s'e përmbajti të qeshurën. Sipas tij, ne kurrë s'do ta arrinim vijën e horizontit. Sapo të niseshim, ajo do të vinte duke u larguar dhe, kur të mbërrinim në kufirin ku na qe dukur se kubeja e qiellit mbyllej, do të shfaqej para nesh një kube tjetër. Në këtë rast, gjyshi përdori një term të ri për hapësirën, një term që s'na e kishte zënë veshi në shkollë.

“Ka metër, ka kilometër dhe milje detare”, tha ai. “Por horizontmetri ua kalon të gjithave. Për atë që kërkon t’i njohë të Tjerët, ata që nuk jetojnë në qytetin e tij apo as në vendin e tij, horizontmetri është masa më e mirë për të zbuluar botën.”

Në mbrëmje, e lodhur nga punët e ditës, Luna u mblodh më herët në dhomën e saj dhe ra për të fjetur. (Mos t’ju duket e çuditshme që, ashtu si babait, në emër i thërrisja edhe mamit qysh në vegjëli. Ata vetë ma kishin lejuar dhe kënaqeshin kur i thërrisja: “O Driti, o Luna!) Kur mbeta vetëm me gjyshin, mua ende më rrinte mendja te kubeja e mbyllur që kishim parë në fillim. Si na ishte zhdukur nga sytë tërë ajo pllajë e madhe, e cila niste në fund të lagjes sonë dhe, në mot të kthjellët, na lejonte të shihnim si përvijohesh silueta e një kodre përtej?! Kishte qytetarë që herë-herë shkonin më këmbë deri atje dhe, në majë të kodrës, i shtonin pirgut të gurëve një gur më tepër. Edhe gjyshi im kishte vajtur dikur. Madje thuhej se, si njeri i dhënë pas mbishkrimeve të moçme dhe librave të vjetër, shenja e tij përmbante një skalitje. Në gurin që i kishte shtuar obeliskut, ishte gdhendur: “Kur nuk shkon drita te njeriu, shkon njeriu te drita.”

Mirëpo atëherë ende s’e kuptoja këtë domethënie. Madje nuk m’u dha ta pyesja as atë mbrëmje, sepse më kishte rrëmbyer horizontmetri i gjyshit. Ai e ndjeu trazimin tim dhe, duke ma hedhur dorën në sup, më siguroi: “Kurdo që ti të nisesh drejt ndonjë horizonti të ri, gjyshi me ty do të jetë. Mbaje mend, patjetër me ty!”

Këto fjalë më tingëlluan si një betim i rëndë. Ishte njëlloj sikur po thoshte: “Në këtë jetë dhe në atë tjetrën!”

Pa gjyshin, besoj ta keni marrë me mend, për të birësuarit ndryshuan kushtet. Këta nuk e hanin më drekën në shtëpinë tonë. Tashmë edhe Luna rropatej duke punuar me orar të zgjatur, ndërsa nga gjyshi nuk trashëguam tjetër pasuri, përveç shtëpisë dhe orendive të saj. Por duhen përmendur edhe librat e vjetër, që nisa t'i lexoja me etje.

Sidoqoftë, kur isha në vitin e parë të shkollës së mesme, ende njihesha si vëlla me pesë sivëllezër. Mirëpo një ditë, sapo mësuesi i historisë na pa së bashku, e dëgjuam të thoshte për ne: “Ja edhe gjysma e dymbëdhjetëshes së Jozefit!” Mua më erdhi ca inat, sepse po ia hante hakun njeriut tim, ai mund të kishte thënë më drejtpërdrejt: “Ja edhe gjashtëshja e Jazit!”

Ndoshta pikërisht atë kohë na lindi ideja për të bërë një pelegrinazh në kujtim të gjyshit. Qemë të gjithë në një mendje, do të marshonim drejt kodrës me obelisk. Mirëpo më parë na lipseshin ca pajime, ndonjërit këpucë të përshtatshme, kurse secilit çanta sportive e shpinës. Ku t'i gjenim të hollat? Mblodhëm aq sa mundëm nga kursimet tona, por ishin fare pak. Kështu, shpëtimtare u bë dhurata e gjyshit, ajo e ditëlindjes kur mbusha dhjetë vjeç. Mbasi i shova dhjetë qirinjtë e tortës, duke më varur në qafë një medaljon, gjyshi më uroi: “Njëqind u bëfsh!” Menjëherë më vetëtiu në gjoks shkëlqimi verdhosh i arit. Të dy anët e medaljonit ishin pakëz të fryra dhe perimetri i hollë, ku bashkoheshin në mes, mezi dallohej. Përveç atij urimit për jetë të gjatë, gjyshi

shtoi pastaj: “Kur të mblidhemi për njëzetvjetorin tënd, po ta kesh ende, edhe mund ta hapim.”

U krijuan gjasat për të mos e patur në atë moshë. Dhe s’ ishte aspak e lehtë për mua, sepse e dija që dhuratat s’ është mirë të shiten. Por dija gjithashtu se për misionin që po ndërmernte gjashtëshja e tij, po të ishte vetë gjallë, gjyshi do të ma falte mëkatin. Me këtë ndjenjë lehtësimi kërkova treg për floririn.

Kur hyra tek argjendari i parë, e mbajti në pëllëmbë të dorës, pastaj vuri në sy monoklin dhe duke përdorur një pincetë, ia ngriti kapakun medaljonit. Ai kishte përballë faqen e brendshme, ndërsa unë të jashtmen që farfurinte nga shkëlqimi. Pasi belbëzoi diçka pa zë për veten, mua më foli me zë:

“Nuk po e vë fare në peshore, sepse këtë flori nuk ka kartëmonedha që mund ta paguajnë. Por përderisa ke vendosur ta shesësh, patjetër e ke një hall. E sa parà të duhen?”

Shumën e vërtetë nuk e kisha llogaritur, prandaj ngrita supet. Ai s’ më la të heshtja gjatë, ma ktheu medaljonin bashkë me ca kartëmonedha. Sipas tij, po m’ i dhuronte vetëm nga kënaqësia që më së pari kisha trokitur tek ai.

Mirëpo unë trokita edhe tjetërkund. Kur po bëhesha gati për t’ ia treguar argjendarit të dytë, pa i hedhur qoftë dhe një sy, më tha: “Unë as shes dhe as blej kurrgjë nga fëmijët. Po sikur ta kesh vjedhur këtë plaçkë?!” Pastaj, si të donte të më vinte në provë, pyeti i penduar se çfarë mbaja në dorë. Duke hapur gishtërinjtë që ta shihte sa më mirë, i thashë se kisha flori dhe doja ta shisja. Kurse ai, si

ta kishte pickuar gjarpri, m'u gërmush tërë nerva pas një çasti: "Mua do të ma hedhësh ti, mor çapaçul?! Mashtrules i ndyrë, vagabond, mbathja sa nuk të kam zënë në dru!" Më vërshoi gjaku në fytyrë dhe dola menjëherë i skuqur deri te veshët, si të isha ndonjë superfajtor.

Argjendari i tretë, ku hyra gjithë siklet, më mbajti ca më gjatë. Unë këtej dhe ai nga ana tjetër e banakut. Ku e kisha parë atë fytyrë, mos ndoshta në kortezhin e gjyshit? E kishte hapur medaljonin, veçse s'po i bëhej ta hiqte nga dora. Kurse në vend të monoklit, tashmë po përdorte syzet optike. Pastaj, teksa s'ia ndante vështrimin faqes së brendshme të kapakut, nisi të më fliste ngadalë. "E përse të duhen paratë ty?", pyeti. "Duam të bëjmë një pelegrinazh në kujtim të gjyshit tim", thashë. "Sa mirë, Jazi e meriton", tha ai. E kuptova se e njihte, pasi vazhdoi shpejt: "Gjyshin tënd e kisha mik dhe tek unë e ka bërë dikur këtë medaljon. Vërtet ti je trashëgimtari i tij, por ai ka lënë edhe pesë nipa të tjerë, sivëllezër të tutë. Gjithë bashkë do ta bëni pelegrinazhin?" "Gjithë bashkë", u përgjigja. Atëherë, si t'i kishte dëgjuar fjalët e argjendarit të parë, ma ktheu medaljonin duke thënë: "Ka flori e flori, por këtë tëndin nuk ka kartëmonedha që ta paguajnë. Prandaj nuk po e vë në peshore. Atij Jazit, ndjesë pastë, i kam patur një borxh dhe meqë nuk ia shleva dot në të gjallë, po shlyhem me trashëgimtarin e tij. Ndihmohet kështu ekipi për pelegrinazhin?"

Shuma e parave u rrit goxha me të hollat që më dha i tretë. Dhuratë po e quaj, sepse atë punën e borxhit më duket e stisi. Përveçse për të ma hequr sikletin, e sajoi për të nderuar kujtimin e mikut të tij.

Dita që kishim caktuar erdhi. Por kaq i ashpër ishte moti, sa prej erës që shungullonte gjithandej, e shtymë marshimin për të dielën tjetër. “Veçse ky nuk është një piknik i zakonshëm, - iu drejtova ekipit, si të isha unë kapiteni. - Ky është pelegrinazh, prandaj shtyrje tjetër mos prisni.” “Nuk presim”, u përgjigjën njëzëri ata.

Në të vërtetë s’patëm ndonjë fat të mirë. Të shtunën ra borë, madje ra edhe duke u gdhirë e diela. Megjithatë bëmë siç kishim thënë, gjashtëshja e Jazit u nis për rrugë. Kur dolëm përtej lagjes sonë, jo vetëm kodrën atje larg, por as tridhjetë metra para nesh nuk arrinim të shihnim. Tymi i mjegullës e kishte mbushur tërë hapësirën. Në këto kushte, më të voglin u detyruam ta kthenim. Si të kishte qenë i gatshëm nga frika, ai spurdhaku nuk kundërshtoi. Duke na përshëndetur me dorë, ia theku vrapit drejt shtëpisë.

Por nuk vonoi dhe një tjetër u kthye me vullnetin e tij. Pastaj, pa kaluar shumë kohë, ai që ishte prapa meje u ankua se po i zihej fryma. Për ta çarë borën, unë ecja në krye dhe njëshkolona e vogël shkelte në gjurmët e mia. Mos po ecja shpejt? E ngadalësova hapin. Por si kaloi një copë herë, me ta kthyer kokën, pashë se vetëm tre kishim mbetur. Tashmë kishte nisur të frynte nga perëndimi dhe tymnaja e mjegullës po shtyej pak nga pak në të kundërt. Papritur, dikush më preku në sup. Kur ktheva kokën, kishim krijuar largësi me marshuesin e fundit, që e kishte ndalur hapin. Sivëllai pranë meje, teksa ngjeshte kapelën deri te veshët dhe shfrynte avull

nga goja, po më shihte me ca sy përgjërues, sikur po më lutej: “Të kthehemi të gjithë tashmë, mjaft me kaq! Ne e bëmë tonën, por nuk ia dolëm dot.”

Më pas ishte e kotë të shihja prapa, sepse e ndieja që kisha mbetur vetëm. Ecja duke u përpjekur të ruaja drejtimin më të shkurtër, që do të më çonte te kodra me obelisk. Asgjëkundi s’dëgjohej zë, asgjëkundi gjurmë hapash. Gjithë rrafshina asaj dite ngjante me një shkretëtirë të nemitur, ku vendin e rërës e kishte zënë bora. M’u kujtua se në një nga librat e vjetër të gjyshit kisha lexuar rrëfenjën për Jozefin me dymbëdhjetë djemtë e tij, atë që kishte përmendur mësuesi i historisë. Një ditë, kur u kthyen nga shkretëtira në shtëpi, njëri nga djemtë mungonte. Dhe ishte pikërisht ai, që Jozefi e kishte më për zemër. Babai i pyeti me ankth se ku ishte Jakobi. Ata u përgjigjën, e hëngrën bishat. Atëherë sytë e tharë të plakut u lagën prej lotëve. Nuk jam i sigurt, por ndoshta është njeriu i parë biblik, për të cilin thuhet se ka qarë. Dhe kishte shkaqe të forta, qante nga dhembja për të birin dhe nga tronditja se mos djemtë e tjerë po gënjenin. E vërteta ashtu ishte. Nga marazi që babai e kishte më të përzemërtin, ata ia kishin shitur Jakobin një karvani arab që përshkonte shkretëtirën.

Teksa sillja në mend këtë rrëfenjë, nuk e pyeta veten se ç’do të thoshte gjyshi për sivëllezërit e mi. Vështirë t’i gjykoje, ata kishin dashur të më shoqëronin, por nuk kishin mundur. Kurse unë ende isha i vendosur. Aq më tepër që edhe megjulla vazhdonte të lehtësohej, duke ma rritur shikimin përpara. Kisha llogaritur që atë rrugë, të cilën në mot të mirë të rriturit e bënë më këmbë për

një orë, unë do ta bëja për dy, ose dy e gjysmë. Mbase të arrija kodrën e të haja diçka, do të pushoja një copë herë. Kthimi bëhej më shpejt, sepse terreni vinte ca i tatëpjetë në atë anë.

Por ndjeva se tashmë edhe lodhja po e bënte të vetën. Sa kisha ecur? Kur do ta shihja kodrën? Ndodhesha ende larg? Ngaqë muskujt e pulpave dhe të kofshëve po m'i mbërthente një mpirje therëse, këto pyetje s'më shqiteshin. Pak nga pak hapat e mi po ngadalësoheshin, ndërsa frymëmarrja më rëndohej vazhdimisht. Ndoshta ritmin e dihatjes ma shtonte edhe heshtja e shurdhët në gjithë atë territor, ku boshllëku dhe vetmia ndiheshin më tepër. Në çastin kur këmbët po më frenoheshin për t'u ndalur, vetvetiu m'u ngrit një afsh nga brenda dhe, thua se përgjigjen e prisja nga qielli, thirra me kokën lart:

“Gjysh, ku je?”

“Këtu jam, pranë teje”, m'u bë se dëgjova zërin e tij.

Atëherë mora zemër dhe e zgjata hapin. Madje, sa herë e ktheja kokën prapa, shihja në borë katër gjurmë, dy të miat dhe dy të tijat. Mos ishte ndonjë fanitje që m'i gabonte sytë? Kot të më kërkoni shpjegime, unë as që dyshoja ndopak, gjyshi ishte me mua dhe unë me gjyshin. Natyrisht, duke pranuar këtë shoqërim, nuk mund të harrohet edhe përtëritja që ndjeva.

Veçse forca kishte qenë e përkohshme. Megjithëse marshova më tej, befas, afër kodrës m'u këputën gjunjët. Atëherë tërë trupi më la në baltë dhe desh u rrëzova.

“Gjysh!” , thirra përsëri. “Ku je, përse më braktise?”

“Aty më ke, me ty jam, Kevini im”, ma ktheu ai.

“Po të ishte këtu”, ngulmova unë, “në borë nuk do të shihja dy, por katër gjurmë.”

“Mos u tremb, ti po sheh aq sa janë”, më qetësoi gjithnjë. “Tashmë, duke të ngritur nga bora, po të mbaj në krahët e mi.”

Ç’ishte kjo përgjigje kaq e mistershme? Ah, ata krahët e tij! Ishin dobësuar e flashkur në pleqëri. Mos po e rëndoja me thirrjet e mia mizore, thua se doja ta ngrija nga dheu, duke i kujtuar premtimin që më kishte dhënë?!.. Fërkova sytë dhe e mblodha mendjen. Gjyshit nuk mund t’ia kërkoja ndihmën në këtë mënyrë, përderisa ura jonë e vetme, unë këtej dhe ai andej, ishte gjuhë shpirtërore.

Sesi u ngjita deri tek obelisku, zor ta them. Kujtoj vetëm se atëherë mjegulla ishte zhदारitur krejt. Nga maja matanë kodrës m’u shfaqën hapësira të reja. Unë kisha arritur pikërisht te drita. Në fillim pashë ndërtesat e larta të një qyteti, ku jetonin njerëz që kurrë s’i kisha njohur. Kurse përtej, nën diellin që i binte pingul, kaltëronte deti. Qielli ishte i pastër dhe larg, shumë larg, kubeja e tij dukej sikur bashkohej butë me blunë e ujit, duke e mbyllur pamjen. Kraharoni m’u mbush me frymë dhe, pa dashur t’ia dija se isha fillikat, fola me zë disi i habitur:

“Horizontmetri!.. Masa e gjyshit për t’i njohur të Tjerët.”

Pastaj, s’di përse, ia përmenda edhe emrin me zë.

* * *

S’kisha bërë as çerekun e rrugës në kthim, kur pashë Lunën tek vinte drejt kodrës. Dhe e dini kush e pasonte?

Tre nga sivëllezërit e mi. E ndjeva menjëherë alarmin për mua. U gëzuan që isha shëndoshë e mirë, por nuk mbaroi me kaq. Edhe në shtëpi, prej një shqetësimi tjetër, Lunës i mbetën të ngrysurat vetullat.

Meqë ishte e diel dhe mamit do ta gjente në shtëpi, atë ditë kishte trokitur te ne një njeri, që kishte zbrazur ankime të rënda ndaj meje, duke më quajtur *mashtroes* e *vagabond*. Sapo dëgjova këto fjalë, që Luna i përsëriti tërë dëshpërim, më vajti mendja tek argjendari i dytë, ai që më kishte zbuar me tërbim: “Mua do të ma hedhësh ti, mor çapaçul?!”

“Çfarë mynxyre ke bërë, biri im?”, m’u drejtua Luna.

Ia rrëfeva të gjitha, pyetjet e atij dhe përgjigjet që kisha dhënë unë. Më duhen ca të holla për marshimin, i kisha thënë, dhe dua ta shes këtë flori. Pastaj... Por Luna më ndërpreu:

“E çfarë pastaj?! Kot ke broçkollitur pastaj, sepse jo çdo gjë që shkëlqen është ar. Çdo metal i zakonshëm, kur lahet me flori, merr ngjyrën e tij... Kurse me gjithë bujarinë, gjyshit tënd nuk ia mbante xhepi për dhurata të shtrenjta.”

Pra, sipas mamit, medaljoni im ishte ndonjë metal i zakonshëm dhe ai malukati, duke e dalluar me një vështrim, kishte pandehur se doja ta mashtroja. Po dy mjeshtërit e tjerë përse ishin sjellë krejt ndryshe, madje ishin shprehur se këtë medaljon nuk ka kartëmonedha që mund ta paguajnë?!..

Duke dashur t’i shkoja misterit deri në fund, i kërkova mamit ta hapnim, pa pritur të bëhesha njëzet vjeç. Ajo u rropat pak, derisa në perimetrin e hollë gjeti buzën e

vockël, ku futi majën e thikës. Pasi një kërcitje e lehtë dhe medaljoni u hap. Në faqen e brendshme të kapakut lexuam: “Nipi im është floriri i vërtetë.”

Ndoshta ishte ruajtur prej meje dhe e kishte fshehur mallëngjimin, prandaj s’e kisha dëgjuar më parë. Por atë mbrëmje Luna psherëtiu për Jazin. Aq shumë kishte besuar gjyshi tek unë, sa edhe tani që vazhdoj studimet universitare, atë horizontmetrin e tij nuk e marr vetëm si një masë për hapësirën dhe njohjen. Prandaj, me kokën nga qielli, vazhdoj t’i them nganjëherë: “Gjysh, me mua je, je me Kevinin tënd!”

Dhe s’di pse, ndiej një drithmë në gjak.

Castelnovo, maj 2014

Kau me pendë dhe gjeli me brirë

Si mbaroi punimet e vjeshtës, për të lehtësuar hallet e dimrit, Shas Taruci mendoi ta shiste njërin nga qetë e parmendës. Meqë edhe në tufën e pulave kishte dy gjela, me atë rast e kandisi veten që ta hiqte njërin.

Me kaun e zi dhe me gjelin e bardhë u nis nga Gjinuci, i njohur për çiftin e minareve të larta, drejt pazarit të Malashtit. Duke dashur të fitonte kohë, zgjodhi rrugën më të shkurtër, atë përmes lumit. Kur arriti në furinë e rrjedhës, ca ngaqë uji po shtohej e ca ngaqë vetë ishte shtatshkurtër, Shasi u ndje aq pisk, sa besoi se po mbytej. Atëherë ngriti kokën lart dhe nisi të lutej: “Më nxirr nga ky rrezik, o Zot! Të premtoj se, po ma shpëtove kokën, paratë që do të fitoj nga kau, do t’i përdor për bamirësi.”

Nuk dihet si e tek, por mbas atij përgjërimi, e hodhi lumin shëndoshë e mirë. Në pazarin e Malashtit dikush e pyeti:

- E sa e shet këtë gjel?
- Tridhjetë e katër mijë, - u gjegj serbes Shas Taruci.
- Euu, po flet havadan, sa një dem e mbake! - u limaks blerësi. - Po kaun?

- Pesë mijë, - tha Shasi, - veçse e shes bashkë me gjelin.

Tjetri ra në mendime, duke dyshuar se mos po ia hidhnin. Po kur i bëri hesapet me kalem, llogaria i doli njësoj: në daç ta paguante gjelin për kaun, në daç kaun për gjelin, po t'i blinte të dy bashkë, do të shpenzonte tridhjetë e nëntë mijë. E kështu, u pajtua dhe pagoi.

Shasi futi paratë në xhep dhe ia mbathi. Me t'u kthyer në Gjinuc vajti te kasollja ku, në skamje e në vetmi, rronte një plak me plakën e tij. Duke hedhur nga dritarja kartëmonedhën pesëmijëshe, tha:

- Unë, robi yt, po e mbaj premtimin, o Zot. Ja ku janë paratë e kaut!

I kënaqur që kishte shpëtuar kryet, kishte lehtësuar barrën e dimrit, kishte gjetur mënyrën për ta falënderuar Perëndinë dhe, pse jo, për ta dëshmuar edhe veten burrë të ndershëm, mori tragën e shtëpisë. Megjithatë u tregua gojëkyçur, s'i kallëzoi as së shoqes, as fëmijëve dhe as fqinjëve për çfarë i kishte ndodhur.

Vjeshta e turrshme, gjithë shira, ia lëshoi vendin dimrit. Në Shëmitër ra bora e parë, që mbeti gjatë nëpër degët e drurëve. Më vonë rosat u panë duke fluturuar drejt veriut dhe njerëzit, të merakosur për gjënë e gjallë, thanë se prapë do të rreshte borë. Por Shasi nuk e vriste mendjen. Për dhitë kishte prerë shkozë të zezë, për kaun kishte ruajtur kashtë misri, ndërsa pulat i mbante me qull krundesh.

Bora tjetër ia behu me furtunë dhe dimri shtrëngoi më tepër. Ndërsa fqinjët po ziheshin gafil për bagëtitë, Shasi ndihej i kënaqur. "Po të kisha pasur dy që dhe dy gjela", shestonte me vete, "si do t'u vija rrotull për